

PROCESVERBAL
nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 10.4.2023

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançevski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, mr.Emilija Janevska, Vesna Simonovska, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z.Petrushevski e hapi seancën e13-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.3.2023.
2. Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup për shkeljen e nenit 55 paragrafi (1) të LSHMAAV dhe të pikës 30 të Udhëzimit për plasim produktesh.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.

7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media.
8. Propozim për marrje të procedurës për kundërvajtje ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive DIBRA TV SHPKNJP Dibër për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.
9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e 12-të e Këshilli të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.3.2023, me tekst siç u propozua.

Pika 2

Z.Trajçevski e arsyetoi Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë. Ai ka shpjeguar se ky radiodifuzer duhej të paguante një shumë të vogël shtesë për të kryer pagesën e plotë të faturës së dhënë për transmetim televiziv. Në afatin e përcaktuar nga fillimi i procedurës për heqjen e lejes në pajtim me faturën e dhënë radiodifuzeri i lartpërmendur kompenzimin vjetor për lejen për transmetim televiziv e pagoi në tërësi dhe për këtë arsye propozohet të ndërpritet procedura.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, nr.08-626 datë 18.3.2015.

Në përputhje me faturën e dhënë radiodifuzeri i lartpërmendur kompensimin vjetor për lejen për transmetim televiziv e pagoi në tërësi.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore Mr.Emilija Janevska e arsyetoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur. Ajo shpjegoi se nga mbikëqyrja e rregullt realizuar në mars të këtij viti është konstatuar se radiodifuzeri ka shkelur rregullat për mbrojtjen e personave të mitur. Ditën kur është kryer mbikëqyrja filmi artistik „Vojnata zavrshi“ („The War Is Over“) ishte transmetuar pa shenjën përkatëse sinjalizuese para fillimit dhe pa shenjën klasifikuese për kategorinë e programit gjatë gjithë kohë zgjatjes.Për këtë arsye, u propozua Këshilli të miratojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse radiodifuzeri ka respektuar Ligjin.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt të kryer programore, nr.10-1175/1 datë 16.3.2023 dhe njëzëri konkludoi ndaj Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur sepse më 1 mars 2023, në filmin artistik „Vojnata zavrshi“ („The War Is Over“) është transmetuar pa sinjalin e duhur paralajmërues para fillimit dhe pa shenjë klasifikimi për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren për mbrojtjen e personave të mitur.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka veprua).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipër duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup për shkelje të nenit 55 paragrafi (1) të LSHMAAV dhe të pikës 30 të Rregullores për plasim (marketing) të produkteve. Ajo shpjegoi se nga mbikëqyrja e rregullt realizuar në mars të këtij viti ndaj TV Klan është konstatuar shkelje e rregullave për plasim (marketing) të produkteve në programe. Transmetuesi në tre programe ka marketing të produkteve, edhe pse sipas Ligjit në këto programe nuk lejohet marketing të produkteve. Për transmetuesin propozohet masë vërejtje publike me afat përputhshmërie prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka respektuar Ligjin.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-1341/1 datë 23.3.2023 dhe njëzëri konstatoi se SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 55 paragrafi (1) të LSHMAAV dhe të pikës 30 të Udhëzimit për marketing të produkteve sepse më 6 mars 2023, në edicionet e emisioneve: „Histori shqiptare“ – program dokumentar, „Shije shtëpie“ – program argëtues-informativ, dhe „Stop“ – talk-show aktual-informativ, është shkelur ndalimi i marketingut të produkteve në këtë programi TV.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është urdhëruar – që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afat të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja Janevska e shpjegoi Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë tregtare Radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se mbikëqyrja e rregullt në muajin mars ka konstatuar shkelje të obligimit për transmetimin e programit në gjuhën maqedonase, për të cilën transmetuesi ka marrë leje për transmetimin e programit. Nga mbikëqyrja është konstatuar se dy përmbajtje janë transmetuar pa përkthim në gjuhën maqedonase. Bëhet fjalë për intervistën e emisionit „Jadi Burek“ me Xhejson Miko, e cila është transmetuar fillimisht në gjuhën angleze, pa përkthim në gjuhën maqedonase, ndërsa përmbajtja tjetër është rast i kufizuar që do ta shpjegon drejtori, dhe bëhet fjalë për emisionin me titull „Македонски песни во Добриниште, Пиринска Македонија 2 2“. “Këngë maqedonase në Dobrinishtë, Maqedonia e Pirinit 2”. Për transmetuesin u propozua masë vërejtje publike me afat për harmonizim prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka respektuar Ligjin.

Z.Trajçevski sqaroi se duhet t'i shqiptohet masë vërejtje publike TV Sonce, sepse intervista në emisionin „Јади Бурек“ me Xhejson Miko është transmetuar fillimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase. Pas përpilimit të Raportit për mbikëqyrje të kryer programore tek ky transmetues, ka pasur bisedë telefonike me autorin e emisionit „Македонски песни во Добриниште, Пиринска Македонија 2“ “Këngët maqedonase në Dobrinishtë, Maqedonia e Pirinit 2”, i cili ka deklaruar se biseda në atë emision nuk ka qenë në gjuhën bullgare por në gjuhën maqedonase, në dialekt që flitet nga popullata në atë rajon. Për këtë arsye gjatë mbikëqyrjes së radhës nuk do të merret parasysh si shkelje, por shkelja nga neni 64 paragrafi (1) i LSHMAAV mbetet sepse intervista është transmetuar pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-1388/1 datë 27.3.2023 dhe njëzëri konstatoi se ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) nga LSHMAAV sepse më 2 mars 2023, në pjesë të emisionit „Јади Бурек“, respektivisht pjesa e intervistës me Xhejson Miko u transmetua fillimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në përputhje me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (tekst i pastruar) nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja Janevska e shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se shkelja i referohet detyrimit që kanë radiodifuzerët për transmetim së paku 30% të veprave audiovizuele maqedonase gjatë ditës dhe gjysmën e këtyre veprave ta transmetojnë nga ora 7,00 deri në ora 19,00. Nga mbikëqyrja e datës 2 mars 2023, shërbimi programor televiziv i SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, ka transmetuar 2 orë 58 minuta dhe 49 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që përbën 13.68% të totalit të programit të transmetuar gjatë ditës, ndërsa në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00 ka transmetuar për rreth 2 orë më pak se minimumi i kërkuar. Për transmetuesin u propozua masë vërejtje publike me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të kontrolluar nëse transmetuesi ka respektuar Ligjin. Ajo theksoi se transmetuesi ka dërguar deklaratë për këtë shkelje e cila është dorëzuar me materialet nën pikën në të cilën thuhet se shkeljet ndodhin për shkak të ndryshimeve të shpeshta të të punësuarve dhe se do të bëjnë përpjekje që në afat sa më të shkurtër kohor të respektojnë Ligjin.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt të kryer programore, nr.10-1387/1 datë 27.3.2023 dhe njëzëri konkludoi se ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, sepse më 2 mars 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as edhe të paktën gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimet për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konkludur nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja Janevska e shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për mediat. Ajo shpjegoi se bëhet fjalë për publikim të impresium për çdo përmbajtje të transmetuar gjatë programit. Ditën kur është kryer mbikëqyrja është konstatuar se në një program nga prodhim i huaj në emision argëtues-informativ „1 Kafe prej Sh'pisë“ („1 Кафе од ќуќата“) nuk janë publikur të dhënat, që është i obliguar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Meqënëse bëhet fjalë për program të huaj në situata të tilla, është e mjaftueshme të transmetohet shpica origjinale e përmbylljes së programit. Për këto arsye u propozua shqiptimi i masës vërejtje publike me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të bëhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka respektuar Ligjin.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-1340/1 datë 23.3.2023 dhe njëzëri konkludoi se ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 nga Ligji për mediat , sepse më 6 mars 2023, në reprizën e transmetuar nga emisioni argëtues-informativ „1 Kafe prej Sh'pisë (1 Кафе од ќуќата)“, nuk i ka publikuar të dhënat, që është i detyruar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat nga Ligji për mediat.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konkluduar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm duhet ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Udhëheqësja Janevska e shpjegoi Propozimin për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive DIBRA TV SHPKNJP Dibër për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se më 16 shkurt 2023 është shqiptuar masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV dhe transmetuesit i është dhënë afat prej 20 ditësh për harmonizim me dispozitat e Ligjit. Më pas është kryer mbikëqyrje kontrolli, i cili është realizuar më 21 mars, dhe është konstatuar se transmetuesi pjesërisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje, gjegjësisht ka mënjanuar shkeljen e nenit 92 paragrafi (3) të LSHMAAV, por ka vazhduar me shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV, gjegjësisht nuk ka së paku 30% program të prodhuar burimor si vepra

audiovizuele maqedonase. Në ditën e kryerjes së mbikëqyrjes janë transmetuar 25% të veprave audiovizuele maqedonase. Për këtë arsye, u propozua që në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Këshilli i Agjencisë të ngren procedurë për kundërvajtje.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor nr.10-1757/1 datë 6.4.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive DIBRA TV SHPKNJP Dibër dhe konstatoi shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive DIBRA TV SHPKNJP Dibër të ngrihet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente, sepse me mbikëqyrjen e kontrollit është konstatuar se më 21 mars 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 9

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-1777/9

04.05.2023
Shkupe

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.